



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.09.2016, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për organizmin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK)”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili, Vexhi Mucmata, Arben Ristani, Aldo Bumci, Keltis Kruja.

Mungojnë:

Spartak Braho, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Jon Smibert – Ekspert i Nivelit të Lartë

Korajlka Bumci - Eksperte e Nivelit të Lartë

Arben Rakipi - Ekspert i Nivelit të Lartë

Artan Hoxha - Ekspert i Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi! Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Në rendin e ditës të mbledhjes së sotme kemi projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar (SPAK)”. Para fillimit të mbledhjes, dua të them dy gjëra:

E para, vonesa e mbledhjes 40 minuta është për shkak se sapo ka ardhur opinioni dhe disa amendamente të paraqitura nga kolegu i opozitës, zoti Bylykbashi dhe u shumëfishuan për të gjithë deputetët, që edhe ne të kemi një pamje më të plotë për shkak të kohës shumë të shkurtër në dispozicion, sepse amendamentet kanë ardhur në *mail*-in e komisionit sot në mëngjes.

Së dyti, dëshiroj t’iu them zotit Bylykbashi dhe kolegëve që do të ishte më korrekte që përpara se amendamentet e PD-së t’i shohim me titra në televizionin “News 24” dhe në kanale të tjera televizive t’i kemi ne në dispozicion. Pra, ndërkohë që po vinim në komision i pamë në titrat e televizioneve. Nuk ka asnjë gjë të keqe që ato t’u shpërndahen edhe medieve. E vetmja gjë është së duhet të vendosim një raport korrekt ndërmjet njëri-tjetrit. Në këtë kontekst, dua të them një gjë të rëndësishme, në të mirë të procesit dhe të qëllimit që ka zoti Bylykbashi dhe cilido prej kolegëve të tjerë, do të ishte e udhës që amendamente të kësaj natyre, që kërkojnë kohë për t’u njohur dhe për të reflektuar, të ishin vënë në dispozicion për komisionin të paktën 24 orë përpara. Duhej një kohë më e gjatë që të reflektonin anëtarët e komisionit, në mënyrë të veçantë relatori dhe ekspertët. Unë e mirëkuptoj faktin që ekspertët e njohin, janë në dijeni, sepse dje pasdite ju jeni takuar me ekspertët e OPDAT-it, por takimet, që mund të bëhen jashtë komisionit, janë takime të tjera dhe dihet që takimet e tjera, në kuadër të punës së komisionit, janë një gjë tjetër dhe janë funksion të tij. Ajo që na intereson të gjithëve është që, të paktën për projektligjet e tjera, edhe në respekt të atij kalendari, do ta quaja të mirëkuptuar ndërmjet nesh, të vendosim që amendamentet t’i kemi 24 orë përpara për ta çuar punën përpara, të paktën relatorët duhet t’i kenë në dispozicion, në funksion të organizimit sa më të mirë të mbledhjes. Edhe një herë, ju kërkoj ndjesë të gjithëve që pritët për fillimin me vonesë të mbledhjes!

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, unë e thashë edhe dje që mbarëvajtja e punës së këtij komisioni, vetëm mbarëvajtje ndoshta nuk ka qenë dhe do të mbahet mend si një nga komisionet, në mos i vetmi, e rralla ad hoc, që marrin përsipër të bëjnë një punë konsensuale. Ai ka funksionuar keq, në mënyrë të ngjashme me komisionet hetimore. Ndërkohë që shumica dërrmuese e praktikave të komisioneve ad hoc, si puna e këtij, kanë funksionuar në mënyrë shumë konsensuale dhe efektive. Kjo ka lidhje edhe më mënyrën sesi ne e ndërtojmë punën me njëri-tjetrin, duke përfshirë edhe batutat apo komentet që bëjmë me mikrofon për të treguar respekt për njëri-tjetrin. Sigurisht që ne e kemi thënë fjalën tonë dhe e kemi të pastër ndërgjegjen, por ky parlament ky komision dhe të gjithë ata që e kanë drejtuar procesin në këtë formë, me këtë lloj kapaciteti dhe me këtë lloj patejdukshmërie dhe mungese transparence që ka pasur në punën e tij dhe në mënyrën sesi një pjesë e komisionit dhe ekspertiza kanë funksionuar së bashku dhe pjesa tjetër është lënë jashtë. Është unik dhe do të quhet “modeli si për të mos e bërë një punë të tillë”. Këtu përfshihet edhe fakti që, mua më vjen keq që, duke nisur punën për një ligj kaq të rëndësishëm, ne duhet të bëjmë diskutime të tilla. Mua më vjen keq dhe besoj të gjithë përfaqësuesve të opozitës që jemi përpara një procesi ku ligje kaq të rëndësishme duhet të miratohen me një nxitim të jashtëzakonshëm. E keni ndërtuar kështu procesin, do ta çoni kështu deri në fund, por pasojat do t’i vuajnë të gjithë. Më pas njerëzit do të tregojnë me gisht se cilët ishin përgjegjës. Ne po jua sjellim amendamente në komision në këtë orë. Nëse ne si komision, jo opozita, do të kishim pasur mundësinë të kishim një tjetër proces, ku mund të ishim ulur dhe të diskutonim me qetësi, edhe kolegët, edhe ekspertët, do të kishim punë konsensuale dhe produktive. Kështu që do t’ia kurseja me shumë dëshirë këtë lloj komenti vetes dhe komisionit, si dhe ekspertëve të nderuar, por besoj se ishte e panevojshme ajo që u tha. E rëndësishme është të fillojmë punën dhe të diskutojmë për këtë ligj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për organizmin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Relator është zoti Manja, i cili do ta ndjekë procesin në vijimësi edhe gjatë shqyrtimit nën për nen.

Për procedurë, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, duke ndjekur edhe përvojën e mbledhjes tjetër të komisionit, unë do të ftoj zotin Bardhi të jetë i pranishëm në momentin e prezantimit të amendamenteve tona, kur të bëhet shqyrtimi nën për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këto janë amendamentet që ne propozojmë këtu. Ky është një proces i këtij komisioni dhe nuk është juaji, zoti Majko. Ju bëni punën e relatorit. Ne kemi këtu ekspertët, të cilët do të na thonë “po”, ose “jo”, por ne kemi gjithashtu edhe ekspertë që kanë punuar dhe kanë bërë amendamente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, zoti Majko, thatë që nuk kanë status?! Kush jeni ju që përcaktoni statusin e ekspertëve?

Fatmir Xhafaj – A ka mundësi të mos bësh replikë, por të thuash atë që ke ndër mend të thuash?!

Zoti Bylykbashi, ne e pranuar edhe herën e kaluar që ta bënte parashtrësën zoti Bardhi. Kjo në thelb nuk ka asnjë gjë të keqe. Sapo folët për rregullsinë e komisioneve, por në rregullsinë e komisioneve dhe në Rregulloren e punës së tyre nuk vijnë ekspertët të mbrojnë amendamentet e deputetëve. Amendamentet i mbrojnë deputetët. Edhe dje amendamentet u paraqiten nga zoti Vasili dhe nga zonja Hysi, pra i paraqitën deputetët dhe nuk sollën ekspertët e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Bylykbashi, edhe një herë, që të jemi korrektë, sepse nuk doja të bëja replikë as me ju për këtë gjë, sepse folët për rregullsinë e komisioneve, pra që ky komision do të mbahej mend. Po, do të mbahet mend edhe për këto gjëra. Çfarë rëndësie ka? E rëndësishme është që ne të bëjmë procesin dhe të ecim përpara. Nuk e konsideroj thelbësore këtë gjë.

A kanë ndonjë vërejtje kolegët e komisionit? Zoti Bardhi, mund të vish t’i prezantosh! Personalisht, jam në favor, sepse kam respekt të veçantë për ekspertët, pavarësisht se kush janë, ndryshe nga partia ku ju bëni pjesë, që nuk lini gjë pa thënë për ekspertët.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, kursejani vetes dhe bëjini këto komente jashtë mbledhjes. Edhe diçka, verifiko se nga të ka dalë kjo puna te “News 24”, sepse nga ne nuk ka dalë.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka ndonjë gjë të keqe, por të m’i kishit sjellë edhe mua.

Fjalën e ka kërkuar zoti Smibert.

Jon Smibert – *(flet perkthyesja)* Zoti kryetar, doja të bëjë një ndërhyrje dhe të thosha që pala jonë i mori amendamentet dhe qëndrimin e opozitës dje dhe i shqyrtaam ato bashkë me

zonjën Bumçi. Kemi përgatitur disa dispozita, disa ndryshime në gjuhën shqipe. I kemi bërë gati. Në qoftë se doni, mund t'ju shpërndajmë tani. Gjithashtu, u takuam me anëtarët e komisionit në mëngjes, përpara se të niste takimi, kështu që janë edhe disa ndryshime të tjera në këto dispozita që i kemi përgatitur në shqip, tashmë, të cilat mund t'i diskutojmë gjatë rrugës.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Kam një vërejtje për ju: shqyrtimi i projektligjeve bëhet në komision dhe jo jashtë tij. Unë nuk kam gjë, përkundrazi, e konsideroj pozitive të ketë shkëmbime mendimesh për draftet në funksion të punës në komision, por do të ishte korrekte, si për kolegët që propozojnë amendamentet, edhe për ju që, të paktën t'i sillnit një ditë më parë amendamentet në komision dhe do të ishte edhe më korrekte që për këtë çështje minimalisht të ishte i pranishëm edhe relatori që të kishte mundësi të reflektonte në kohë.

Gjithsesi, do të dëgjojmë prezantimin e amendamenteve të zotit Bylykbashi, pra prezantimin që do ta bëjë zoti Bardhi, eksperti i grupit parlamentar të PD-së, ndërkohë që do t'ju lutem që amendamentet që keni përgatitur në shqip, në reflektim të takimeve të mëparshme me Partinë Demokratike t'ju shpërndani kolegëve të komisionit, që të njihen, të kenë kohën e mjaftueshme për t'i parë. Do të kërkoj nga ju dhe nga relatori që në përfundim të prezantimit, që do të bëjë zoti Bardhi, të jepni komentet tuaja lidhur edhe me disa sugjerime dhe propozime për të përmirësuar draftin, që ka sjellë me shkrim zoti Vasili. Relatori, gjithashtu, ka sjellë disa sugjerime dhe propozime konkrete. Besoj se i keni marrë ato sugjerime që të bëni një vlerësim, siç keni bërë për opinionin dhe amendamentet e PD-së, edhe për ato të kolegëve të tjerë; nëse e keni të gatshëm. Do t'ju japim mundësinë të flasim zotit Smibert dhe zonjës Bumçi, ekspertëve që janë këtu, pasi zotit Bardhi.

Zoti Bardhi, mund ta merrni fjalën për të prezantuar opinionin e kolegëve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, bëni një paraqitje të përgjithshme të opinionit tuaj lidhur me projektin dhe të amendamenteve për çështjet kryesore!

Gazmend Bardhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Çështja e parë e që ne ngremë...

Fatmir Xhafaj – Ju kërkoj të falur! Fjalën e ka zoti Vasili për procedurë.

Petrît Vasili – Ne vërtet kemi hyrë në një proces, por unë them një gjë: ne besoj se nuk kemi ndonjë nevojë si komision për një paraqitje integrale të kurrkujt, as të zotit Bardhi, madje

edhe të zotit Manja. Ne kemi këtu një çështje konkrete. Në tavolinë kemi një seri amendamentesh të paraqitura nga Partia Demokratike. Unë them se, në qoftë se ne duam të jemi racionalë, të hyjmë në kohë, sepse ne jemi dakord të gjithë me Byronë e Hetimit, për këtë gjë e kemi futur në Kushtetutë. Nuk kemi se çfarë të diskutojmë më në princip. E kemi dhënë atë mbështetje. Tani duhet vetëm të riformulojmë ligjin. Në ligj verifikohet se kemi diferenca. Hajde të hyjmë direkt te diferencat! Thelbi i gjësë për mua, të paktën në pikëpamjen personale, janë këto amendamente dhe debati përqendrohet këtu. Sinqerisht, me shumë respekt, unë nuk kam asnjë interes personal të dëgjoj një ekspozë të gjerë.

Fatmir Xhafaj – Besoj se zoti Bardhi do të bëjë një ekspozë të shkurtër.

Petrit Vasili – Unë them të hyjmë direkt në thelb, në rast se nuk keni gjë në parim. Zoti Bylykbashi, besoj se thelbi janë amendamentet. Duhet të jemi racionalë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Vërejtja e zotit Vasili është racionale në këtë pikëpamje, që të jemi sa më eficientë në këtë gjë.

Oerd Bylykbashi – Sapo iu shpërndanë komisionit propozimet e ekspertëve. Unë jam në dijeni për këtë, por do të ishte mirë që, në një mënyrë ose në një tjetër, edhe duke pasur nevojë të kemi një mbledhje...

Fatmir Xhafaj – Jeni apo nuk jeni në dijeni për këtë? Në qoftë se ka një njeri në këtë sallë që ka dijeni për amendamentin e zoti Smibert, ai jeni ju.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, për efekt të punës së komisionit, që të mbetet në rekordet e tij, po të jetë e nevojshme, të bëhet edhe një mbledhje sot gjatë ditës, për ta përmbyllur, që propozimi të bëhet një dokument parlamentar dhe të vijë në një formë të caktuar dhe të përfshihet në punën e komisionit.

Pandeli Majko – Më vjen keq që këtu po vendoset një dyshim për procedurat lidhur me qenien ose dokument, brenda logjikës së punimeve të komisionit, vërejtjet ose sugjerimet që vijnë nga EURALIUS dhe nga OPDAT-i, sepse ata e kanë pasur këtë status që në fillim të punës së komisionit; kanë bërë vërejtje gjatë procedurave, që janë miratuar nga komisioni. Këto vërejtje janë dokument që në momentin kur na dorëzohen. Jemi në pastaj ata që vendosim nëse do t'i marrim parasysh, qofshin ato të ekspertëve shqiptarë apo të ekspertëve ndërkombëtarë.

Lidhur me faktin që mund të doni kohë të shikoni ndonjë gjë, mendoj se në këtë pikë duhet të keni të njëjtin mirëkuptim që kemi treguar ne karshi jush, që na i dhatë sot, përpara 1 orë, vërejtjet tuaja dhe ne u ulëm në tavolinë për të diskutuar.

Fatmir Xhafaj – Zoti Vasili, pastaj zonja Hysi.

Petrit Vasili – Zoti Kryetar, në tavolinë kemi disa amendamente të tjera shtesë, që i ka sjellë zoti Smibert, të cilat kanë buruar nga amendamentet ose propozimet që ka bërë PD-ja. Minimumi, se ne do të rrezikojmë përsëri një muaj në hava, unë do të propozoja miqësisht që ta ndërpresim për 1 orë ose për gjysmë ore, sa të doni, të shikojë PD-ja se cilat prej tyre janë të reflektuara. Nëse ka reflektime, të mos merremi me çdo amendament, por të dimë të themi “neni 1 nuk ka”, apo nëse jemi dakord me reflektimet e zotit Smibert. Në këtë mënyrë, edhe lexojmë, edhe fitojmë kohë, se kështu ne nuk bëjmë gjë fare. Nuk na gjen gjë, sepse besoj se të gjithë do t’ia dedikojnë ditën kësaj çështjeje. E ndërpresim për një orë. PD-ja shikon me qetësi se çfarë është reflektuar dhe çfarë jo, pastaj ecim përpara. Ne vërtet po hyjmë në vorbull pa kuptim. Do ta “vrasim” kohën kot.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Edhe unë dua të flas për procedurë, zoti kryetar. Mua më duket i tepërt sugjerimi i zotit Bylykbashi. Unë ndihem keq që ne jemi në pozita të disfavorshme. E theksova dje, po e theksoj edhe sot: kemi punuar gjatë gjithë muajve të verës. Kolegët e opozitës i kanë të gjitha draftet dhe opinionet tona. Ne jemi në pozita të disfavroshme, sepse vihemi para faktit të kryer, një çerek ore përpara se të fillojë mbledhja, dhe i gjejmë mbi tavolinë amendimet.

Lidhur me propozimet që sjell OPDAT-i, ai nuk ka pse t’i sjellë në formë procedurale një riformulim, sepse edhe gjatë diskutimeve që ne bëjmë në mbledhje mund të bëjmë riformulime, siç kemi bërë vazhdimisht.

Ju ka bërë një nder të madh që e ka marrë oponencën tuaj 20 orë para dhe ne, pjesa tjetër e komisionit, vijmë këtu si bufa dhe nuk e dimë se çfarë është bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Ju lutem!

Zoti Bylykbashi, ruani qetësinë, ju lutem!

(Zoti Bylykbashi ndërhyn pa mikrofon.)

Ka të drejtë zonja Hysi, sepse ka qenë relatores dhe gjatë gjithë muajit gusht nuk ka bërë një ditë pushim, zotëri.

(Zoti Bylykbashi ndërhyr pa mikrofon.)

Duhet të kemi respekt edhe për punën e kolegëve, ju lutem! Ky është shqetësimi dhe është i ligjshëm; duhet ta mirëkuptojmë këtë gjë.

Zoti Bardhi, mund të vazhdoni, ju lutem! Besoj se mbaruan diskutimet për procedurë, ju kërkoj ndjesë dhe nuk do të lejoj që t'ju ndërpresin më.

Gazmend Bardhi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shqetësimi i parë që është ngritur në opinionin e Grupit Parlamentar të PD-së ka të bëjë me parashikimet për përbërjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, ku në parashikime të caktuara të ligjit sanksionohet që një pjesë e punonjësve të BKH-së të emërohen nga Policia e Shtetit apo nga organe të tjera të pushtetit ekzekutiv. Në vlerësimin tonë kjo bie ndesh me varësinë ekskluzive që neni 148 i Kushtetutës i ka njohur BKH-së vetëm nga Prokuroria e Posaçme, si i tillë, parashikime të tilla, në vlerësimin tonë bie ndesh me parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Për këtë kemi propozuar amendamentet që në dokumentin tuaj janë të shënuara: amendamenti nr. 2, nr. 4, nr. 7, nr. 8, nr. 10 dhe nr. 12, të cilat rregullojnë varësinë e të gjithë punonjësve të BKH-së vetëm nga Prokuroria e Posaçme, ashtu siç e ka specifikuar neni 148 i Kushtetutës, pa pasur mundësi ndërhyrjeje nga Policia e Shtetit apo institucione të tjera të pushtetit ekzekutiv, që jo vetëm të emërojnë apo të organizojnë procesin e konkurrimit dhe të rekrutimit të punonjësve të BKH-së, por edhe të rregullojnë aspekte të caktuara të organizimit të këtyre shërbimeve. Kjo është çështja e parë, e cila lidhet me amendamentet nr. 2, nr. 4, nr. 7, nr. 8, nr. 10 dhe nr. 12.

Çështja e dytë e rëndësishme, e ngritur në opinionin tonë, lidhet me verifikimin e kushteve paraprake të sigurisë. Aktualisht, projektligji i propozuar parashikon një rol domethënës dhe aktiv të strukturave të jashtme në emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Do të mjaftonte një opinion negativ i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, që një gjyqtar dhe një prokuror të mos emërohet dot në Gjykatën e Posaçme, në Prokurorinë e Posaçme apo në BKH. Në vlerësojmë që kjo është ndërhyrje dhe influencë e papërshtatshme e pushtetit ekzekutiv në pavarësinë e Gjykatës së Posaçme Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së dhe për këtë kemi paraqitur amendamentet nr. 3, nr. 5, nr. 15 dhe nr. 16. Zgjidhja që ne kemi ofruar nëpërmjet një komisioni ad hoc. i përbërë nga pesë anëtarë, është e përafërt me atë zgjidhje që,

aktualisht, përmbajnë nenet 51 dhe 52 të ligjit, sepse ka një mospërputhje në draftin që ju keni përpara midis nenit 6 të projektligjit dhe neneve 51 dhe 52 të projektligjit. Pra, neni 6 është ndryshuar, besojmë në momentet e fundit, ndërkohë ky ndryshim nuk është pasqyruar te nenet 51 dhe 52. Nenet 51 dhe 52 bëjnë fjalë për verifikimin e pasurisë dhe integritetit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit, zgjidhje të cilën ne e pranojmë si zgjidhje për një periudhë transitore, për aq kohë sa ky komision do të jetë në funksionim, sepse do të jetë vetëm për një periudhë 5-vjeçare, sipas Kushtetutës. Ndërkohë që rregullimi i rekrutimi të gjyqtarëve dhe prokurorëve është një rregullim që i shtrin efektet më shumë se 5 vjet, pra për aq kohë sa do të ekzistojnë prokuroritë e posaçme dhe gjykatat e posaçme. Për këtë arsye ne kemi propozuar që roli i komisionit, pas përfundimit të veprimtarisë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, të bëhet nga një komision ad hoc i përbërë nga një gjyqtar i gjykatave të posaçme dhe dy prokurorë, një punonjës i Prokurorisë së Posaçme, pjesë e strukturës së hetimit financiar, dhe një hetues i BKH-së. Për këtë çështje, e përsëris, kemi paraqitur amendamentet nr. 3, nr. 5, nr. 15 dhe nr. 16.

Çështja e tretë e rëndësishme, e ngritur në opinionin tonë, ka të bëjë me monitorimin e telekomunikimeve dhe të dhënave financiare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe punonjësve të BKH-së.

Së pari, zgjidhja e ofruar nga projektligji, që mbikëqyrjen e të dhënave financiare të gjyqtarëve dhe prokurorëve ta bëjë një organ nën varësinë direkte të pushtetit ekzekutiv, në vlerësimin tonë, përbën ndërhyrje në pavarësinë e këtyre strukturave. Nga ana tjetër, kontrollin apo monitorimin e telekomunikimeve nga një punonjës i BKH-së e kemi vlerësuar si një garanci të ulët për të drejtat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Propozimi ynë fillestar ka qenë që monitorimi të bëhet nën drejtimin dhe kontrollin e një prokurori. Pra, të jetë prokurori ai që kontrollon apo monitoron qoftë telekomunikimet, qoftë të dhënat financiare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjykatave të posaçme. Për të shmangur kontrollin e mbyllur, le të themi, nga vetë prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, që bëjnë kontrollin e njëri-tjetrit, propozimi ynë ka qenë që këtë detyrë të kryejë një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme i zgjedhur me short.

Fatmir Xhafaj – Më fal, nuk e dëgjova, përsëriteni edhe një herë, ju lutem!

Gazmend Bardhi – Për monitorimin e telekomunikimeve dhe të dhënave financiare të gjyqtarëve dhe prokurorëve të posaçëm, për të pasur një kontroll efektiv, kemi propozuar që të ketë një kontroll të jashtëm.

Zgjidhja që ofron aktualisht ligji është që kontrolli i jashtëm të bëhet nga qeveria, nga Drejtoria e Parandalimit dhe e Pastrimit të Parave, që është organ i pushtetit ekzekutiv, është organ i qeverisë; e bëjnë ata kontrollin sipas projektligjit. Propozimi ynë është që kontrolli vërtet të jetë i jashtëm, por të jetë nga një organ i pavarur, siç është prokuroria. Për të mos ia ngarkuar detyrën prokurorit të Përgjithshëm apo diskrecionit të tij për të caktuar një prokuror për ta kryer këtë detyrë, ne kemi propozuar që të jetë një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, por i zgjedhur me short, pra për t'i shmangur diskrecionin për zgjedhje prokurorit të Përgjithshëm. Nga diskutimet e bëra kemi konkluduar që, ndoshta për shkak të parashikimit që Prokuroria e Posaçme është e pavarur nga Prokuroria e Përgjithshme, sikundër është e pavarur edhe nga qeveria, e njëjta logjikë vepron edhe në rastin e parashikimit për Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, minimalisht duhet që projektligji të parashikojë që oficerët përgjegjës të monitorimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit apo të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave duhet ta bëjnë këtë detyrë nën drejtimin dhe kontrollin e një prokurori. Pra, kjo veprimtari për sa kohë prek të drejtën për jetë private të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, dhe mund të jetë një mekanizëm ndërhyrjeje edhe në veprimtarinë e tyre, nuk mund të bëhet jashtë kontrollit të një prokurori. Nëse vlerësohet e papërshtatshme, që ky monitorim kontroll dhe drejtim të bëhen nga një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme, i zgjedhur me short, duhet që të jetë një prokuror i vetë Prokurorisë së Posaçme. Për këtë kemi paraqitur amendamentet nr. 13, 14, 17, 19 dhe 20.

E përsëris, propozimi për ta kryer këtë detyrë një prokuror në Prokurorinë Përgjithshme lidhet me nevojën për të pasur kontroll efektiv, që të mos jetë brenda vetë strukturës, pra që vetë anëtarët e strukturës të kontrollojnë veten apo kolegët e tyre. Një kontroll i jashtëm nga një organ i pavarur do të ishte një kontroll më efektiv.

Çështja e katërt që është ngritur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka të bëjë me kriteret e emërimit të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilat, nga mënyra sesi janë parashikuar në ligj, nuk garantojnë kandidimin e lirë dhe mundësinë për të përthithur personin që ka kualifikimin më të mirë dhe që gëzon integritetin më të lartë, po ashtu nuk përjashtohen, nga kriteret e vendosura nga ligji të gjithë ata individë që kanë kryer detyrën e gjyqtarit, prokurorit apo hetuesit gjatë periudhës komuniste. Për këtë kemi paraqitur amendamentin nr. 11, që riformulon nenin 36 të ligjit aktual.

Një tjetër çështje e rëndësishme e ngritur në opinionin tonë, ka të bëjë me shmangien e diskutimit nëse ka apo jo aktualisht Prokuroria e Përgjithshme kompetencë për të hetuar zyrtarët

e lartë, në vijim edhe të shqetësimit të paraqitur nga prokurori i Përgjithshëm, ne kemi propozuar që deri në ngritjen e SPAK-ut, që do të jetë një periudhë relativisht e gjatë, pra është e vërtetë që ligji mund të miratohet në shtator dhe mund të hyjë në fuqi në tetor, por ngritja e Prokurorisë së Posaçme do të kërkojë një kohë rreth 10 muaj për filluar funksionimin. Ne mendojmë se ligji duhet të përcaktojë një rregull transitor që gjatë kësaj periudhe kompetencat e SPAK-ut do të kryhen respektivisht nga prokurori i Përgjithshëm, nga Prokuroria e Krimeve të Rënda apo prokuroritë rretheve, sipas parashikimeve që ka pasur legjislacioni ekzistues përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese. Në këtë mënyrë zgjidhet edhe shqetësimi i ngritur për mungesë baze kushtetuese apo ligjore për të kryer hetimet e zyrtarëve të lartë dhe hiqet çdo diskutim mbi bazushmërinë në ligj të këtyre hetimeve.

Këto ishin 5 çështjet kryesore që ka ngritur opinioni i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike, sigurisht që ne kemi bërë sugjerime apo komente edhe për pjesë të tjera të dispozitave të projektligjit, të cilat i kemi lënë në vlerësimin e komisionit dhe të grupit të punës, që ka punuar me hartimin e projektligjit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Bylykbashi, keni ndonjë koment?

Oerd Bylykbashi – Kam një koment të shkurtër në lidhje me çështjen që ngriti zoti Bardhi, në lidhje me pikën 3, pra për kontrollin që bëhet për veprimtarinë e prokurorit të Prokurorisë së Posaçme, por edhe të gjyqtarëve pa ripërsëritur ato që tha zoti Bardhi, unë besoj se është një çështje që duhet marrë me shumë seriozitet fakti që kontrolli për punën që bëjnë këta, pra eventualiteti i veprimeve me karakter korruptiv apo kriminal nga gjyqtarët apo prokurorët e Prokurorisë së Posaçme, i bërë vetëm nga ata, nga brenda, ngelet në princip problem. Do të ishte mirë që kontrolli të ishte nga jashtë. Do të kishim një sistem kontrolli brenda përbrenda sistemit të prokurorisë, që do të na garantonte nga një anë pavarësinë, por nga ana tjetër, kjo strukturë e re, por e vogël, të kthehet më keq se një korporatë. Por në çdo rast është një minimum absolut dhe i padiskutueshëm për sa na përket neve, në raport me Kushtetutën që ky kontroll i transaksioneve financiare dhe telekomunikimeve të këtyre zyrtarëve me një mandat kushtetues shumë të fuqishëm, të jetë i kontrolluar nga degët e ekzekutivit. Çfarë bëjnë ata, cilat janë bisedat e tyre telefonike, mesazhet apo transaksionet e tyre nuk mund të kontrollohen nga ekzekutivi, sepse do të ishte një cenim shumë i rëndë i pavarësisë së këtij institucioni. Nëse nuk

pranohet ajo që ne kishim propozuar, pra një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme i përcaktuar me short, megjithëse në gjykimin tim nuk cenon pavarësinë, mbetet problem fakti që këta zotërinj do të kontrollojnë veten e tyre me mënyrën sesi ata e kryejnë punën e tyre. Shpresoj të mos ia shohim frytet hidhura në të ardhmen, një lloj vëllazërie të çuditshme që mund të krijohet brenda organit. Kështu që është detyra jonë të bëjmë maksimumin e kontrollit, të ushtrojmë kontroll politik, po të jetë i nevojshëm që kjo të mos ndodh, por problemi mbetet, kemi tentuar ta zgjidhim, le ta shikojmë se cila do të jetë zgjidhja finale. Besoj se duhet të jetë problem për të gjithë ne sepse është problem sistemik.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje?

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, është pak e vështirë për t’u shprehur për të gjitha ato që tha zoti Bardhi, por unë që në fillim gjej një kontraktitë shumë të madhe në atë që ju parashtruat zoti Bardhi dhe atë që ritheksoj zoti Bylykbashi. Nga njëra anë, ju thoni: “Nuk duhet të lejojmë që të krijohet një vëllazëri”, pra, nga ana tjetër, gjithçka duhet të jetë jashtë ekzekutivit. Realisht nuk arrij të kuptoj se çfarë kërkoni. Ju thoni: “Kontrollin e pasurisë, të pastërtisë, të deklaratave duhet ta bëjë një komision *ad hoc* i krijuar nga prokurorë të Prokurorisë së Posaçme”. Nga ana tjetër, në amendim ju thoni: “Asnjë nga kandidatët për prokuror në Prokurorinë e Posaçme ose për punonjës nuk mund të fillojë nga puna pa iu nënshtruar procesit të verifikimit të deklaratave dhe të pastërtisë”. Atëherë, në momentin fillestar të konstituimit të këtyre institucioneve, nga kush do të përbëhet ky komision *ad hoc*, ku Prokuroria e Posaçme nuk është krijuar dhe nuk mund të krijohet pa bërë verifikimin, pra dikush duhet ta bëjë verifikimin?

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi – Ajo që ne thamë është se janë dy çështje: një është cenimi i pavarësisë, dhe kjo vjen nga institucionet e ekzekutivit, komenti im ishte për çështjen e tretë që ngriti zoti Bardhi, dhe çështja tjetër është mundësia për një korporatizëm të theksuar, por le të marrim të gjitha masat që të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme që kjo të mos ndodhë. Kontrolli që ju propozoni, pra verifikimi paraprak që duhet bërë nga ILDPK-ja dhe DSIK-ja, por kjo është çështje tjetër, ka bëjë me faktin se kemi institucione nën kontrollin e ekzekutivit, të cilët do të japin dakordësinë në qoftë se dikush bën apo nuk bën për të punuar në këto struktura të pavarura. Ky do të ishte një cenim, përsëri në një pikë tjetër, të pavarësisë. Propozimi ynë

është që kjo nëpërmjet një regjimi transitor, të shkojë drejt asaj që është një komision *ad hoc*, i cili do ta bëjë verifikimin, por nuk ka punë në këtë çështje as ILDKP-ja, as DSIK-ja, për më tepër, vetë në draftin tuaj, në një pjesë të këtij lloji procesi e parashikon një komision *ad hoc*. Pra, ka dy parashikime të ndryshme dhe ne mendojmë se ajo duhet të jetë zgjidhja finale.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Bardhi!

Gazmend Bardhi – Për emërimet e para që do të bëhen në institucion, pra në momentin që ato do të ngrihen, për gjyqtarët dhe prokurorët është zgjidhur, sepse do t'i nënshtrohen procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili do të bëjë qoftë vlerësimin e pasurisë, qoftë vlerësimin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nëse ata e kalojnë testin e verifikimit dhe rivlerësimin nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, do të thotë se gëzojnë integritet dhe e kanë të pastër figurën e tyre, sikundër nuk kanë probleme edhe me ligjshmërinë e pasurisë. Ky kontroll do të bëhet nga Komisioni i Pavarur. Sigurisht, komisioni gjatë kryerjes së detyrës do të marrë të dhëna nga ILDKP-ja, DSIK-ja dhe çdo institucion tjetër që ka të dhëna mbi këto dy komponentë. Ndërsa për sa i përket punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për sa kohë komisioni nuk mund të jetë i kompozuar me 5 anëtarë, ne kemi propozuar, që për një periudhë transitore 2-vjeçare komisioni të përbëhet vetëm nga prokurorët dhe gjyqtarët. Pse kemi zgjedhur periudhën transitore 2-vjeçare? Në nenin 60 të projektligjit parashikohet që për 2 vjet procesi i rekrutimit të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit do të monitorohet nga një komision rishikimi, i përbërë nga ekspertë të BE-së dhe SHBA-ve. Ne besojmë se mbikëqyrja e këtyre në një komision me 3 veta do të sjellë një kontroll dhe verifikim efektiv të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Pra është dhënë zgjidhje përjashtimore, transitore në pikat 6 dhe 7 të nenit të riformuluar nga ana jonë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Manja!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, në opinionet e shprehura nga opozita ngrihen 5 probleme, por unë dua të them se nga këto amendamente apo shqetësime që ngre opozita dy janë thelbësore dhe kanë të bëjnë me thelbin e ligjit. Pra, ne kemi rënë parimisht dakord që në funksion të pavarësisë së strukturave të SPAK-ut që, për të garantuar pavarësinë maksimale në ushtrimin e funksioneve, të mos lejohet asnjë formë e jashtme kontrolli, pra të mos ketë asnjë ndërhyrje nga jashtë në punën dhe

veprimtarinë e kësaj strukture. Këtu propozohet që mbikëqyrja dhe monitorimi i kësaj strukture të bëhet nga një prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme ose të gjendet një formë tjetër sesi mundet të ketë kontroll mbi këtë strukturë, që të mos ketë njëfarë vëllazërie profesionale. Tani, problemi është në frymën e projektligjit, në variantin që paraqitet, nuk është se ndikimi do të jetë i strukturave të ekzekutivit. Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, ILDKPI-së e kështu me radhë. Gjithkund flitet se është drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ai që e vendos vulën i fundit. Edhe mbi këtë formë kontrolli që bën ILDKPI-ja, Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Autoriteti i Sigurisë Kombëtare lidhur me figurën, është drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe inspektori i mbikëqyrjes, më pas në vazhdim, që mban nën kontroll telekomunikimet dhe të gjithë veprimtarinë. Pra, mua nuk më duket se roli i strukturave të ekzekutivit është primar për sa i përket kontrollit të figurës, pasurisë dhe kështu me radhë, sepse në finale nga fryma e projektligjit në mënyrën që paraqitet del se asnjë gjë nuk mund të bëhet pa pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Tani, unë nuk them se kështu siç e ka projektligji apo kështu siç sugjeroj unë është më e mira, por çështja është parimore: do ta lejojmë një ndërhyrje nga jashtë në kontrollin dhe ushtrimin e veprimtarisë së kësaj strukture.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, këtu kemi rënë dakord.

Së dyti, në lidhje me Byronë Kombëtare të Hetimit, qartazi propozohet që në përbërjen e Byrosë Kombëtare të Hetimit, siç përcaktohet në nenin 5 të draftit që kemi përpara, propozimi juaj ka të bëjë me faktin se në përbërje të Byrosë nuk duhet të jenë shërbimet Policisë së Shtetit, se aty është meraku i madh.

Tani, nëse themi kjo strukturë ka atributet e Policisë Gjyqësore, edhe propozimi juaj në këtë frymë shkon, por ju thoni: “Strukturë e pavarur dhe e specializuar hetimi që ushtron atributet e Policisë Gjyqësore”. Po thatë “atributet e Policisë Gjyqësore”, siç e definon edhe Kodi i Procedurës Penale, atëherë nuk është krejt normale që strukturat e BKH-së të kenë në përbërje edhe shërbimet Policisë Gjyqësore, sepse hetimi është shumë kompleks. E ka definuar Kushtetuta që varësia procedurale dhe administrative e kësaj strukture do të jetë pranë Prokurorisë së Posaçme, por pasja në dispozicion e Byrosë Kombëtare të Hetimit edhe të shërbimeve të tjera të Policisë Gjyqësore, shkon në funksion të realizimit të një hetimi të shpejtë, objektiv dhe dinamik. Pse? Sepse në draftin që paraqitet thuhet: “Shërbimet e Policisë Gjyqësore

në varësi të BKH-së në institucionet e tjera, përfshirë dhe Policinë e Shtetit, do të rekrutohen duke plotësuar kushtet shtesë, do të jenë pjesë e trupës së BKH-së edhe për sa i përket trajtimit financiar dhe administrativ, sepse varësia procedurale është e zgjidhur me Kushtetutë, dhe do të jenë nukle të kësaj strukture, pra të BKH-së, në këto institucione”. Ne që vijmë nga prokuroria e dimë që nuk mundet kurrësi asnjë agjenci e zbatimit të ligjit të ketë rezultat në punën e saj pa ndihmën agjencive të tjera ligjzbatuese. Çështja e varësisë procedurale 1 dhe e varësisë administrative 2 është e zgjidhur në ligj. Kështu që ngushtësimi që të thuhet: “vetëm BKH-ja dhe vetëm oficerët e BKH-së do të jenë ata, të vetmit që do të merren me gjithçka”, nuk shkon në funksion të qëllimit të hetimit dhe të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në radhët e zyrtarëve të lartë.

Tani, në rast se ka një shqetësim sot opozitar lidhur me ato pretendime që ju keni ngritur, ministrat e Rendit dhe të Brendshëm në këtë vend shkojnë dhe vijnë, ministrat e Drejtësisë shkojnë e vijnë, por agjencitë ligjzbatuese në funksion të hetimit të veprave penale kanë detyrat e tyre kushtetuese dhe nuk mund të lidhen me një shqetësim që, në fund të fundit, mund të jetë edhe shqetësimi i karakterit politik. Kështu që në këtë kuptim të tjerat edhe mund të diskutohen, sepse çështja e propozimit pasja e një dispozite kalimtare, pavarësisht se është e qartë në Kushtetutë, është krejt normale të ketë një dispozitë kalimtare. Tani unë e lexoj ndryshe Kushtetutën nga prokurori i Përgjigjëm, i nderuar koleg.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti e lexon ndryshe nga unë, por nuk është e thënë ta lexoj edhe unë si ti. Unë kam mendimin tim, natyrisht kam punuar edhe prokuror 13-14 vjet dhe e di si funksionon prokuroria. Kështu që ai e lexon ashtu, unë e lexoj kështu. Megjithatë ne këtu jemi, për t’ia lexuar punën organeve dhe agjencive të hetimit, kërkohet një dispozitë transitore dhe ne nuk kemi asnjë lloj pretendimi pse të mos ketë një dispozitë transitore në ligj, është krejt normale, nuk ka asgjë të keqe.

Edhe për pjesët e tjera, lidhur me komisionin ad hoc, lidhur me kushtet e sigurisë shtesë që duhet të plotësojnë punonjësit e BKH-së, propozimet i keni mbi tavolinë, janë rakorduar edhe me ekspertët e OPDAT-it, e lamë që për procedurë që të kemi një hapësirë kohore që t’i marrim dhe t’i konsultojmë dhe të kemi një draft të integruar me ato që do të pranohet, dhe me atë që do të diskutohet.

Ndërsa të dy çështjet, ajo e BKH-së dhe e monitorimit dhe e mbikëqyrjes nga jashtë, janë çështje parimore.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Bylykbashi, keni një ndërhyrje.

Oerd Bylykbashi – Zoti Manja, siç e lexova mjaft qartë, kontrolli nga prokuroria është kontroll nga jashtë që cenon pavarësinë, kurse fakti që kontrollin e bën Drejtoria e Pastrimit të Parave, me të gjitha ato që dinë të gjithë për atë dhe drejtuesin e saj, është kontroll i brendshëm, nuk është problem. Në qoftë se koncepti është që Prokuroria e Posaçme është pjesë e ekzekutivit, unë jam dakord me ju, por nuk është kështu. Kështu që e keni gabim në germë, në frymë, si të doni, leximin e Kushtetutës në këtë pikë, jo vetëm kaq, por edhe Gjykata Kushtetuese, kur është shprehur në lidhje me çështje të ngjashme, e ka bërë të qartë këtë pjesë.

Për sa i përket kësaj që ju thoni: “Shërbimet e Policisë Gjyqësore duhet të jenë te policia, sepse nuk mund t’i ketë të gjitha”, është e shkruar në ligj, zoti Manja. Byroja Kombëtare e Hetimit ka në përbërjen e saj, pra janë pjesë integrale e Byrosë, shërbimet e Policisë Gjyqësore, sigurisht kanë edhe të tjera, por po flasim për atë që është në përbërjen e saj dhe çfarë është në përbërjen e saj është e saja, rregullohet, drejtohet dhe rekrutohet prej saj, nuk mund të jetë nga jashtë. Për më tepër, po të konsultoni versionet fillestare të sjella edhe nga ekspertët e huaj, në fakt, nuk ka qenë futja e policisë në këtë proces, në rol, ka hyrë më vonë. Nuk ka rëndësi, çështja është principale, nuk mund të ndërhyjë policia për një gjë që është e saja, e Byrosë. Ata dinë t’i bëjnë vetë edhe urdhrat dhe të vendosin kriteret, le ta bëjnë ata procesin e rekrutimit. Për një periudhë 5-vjeçare eventualisht këta funksionojnë, nesër kthehen në detyrë, por nuk ka punë policia këtu, sepse janë shërbime të Policisë Gjyqësore që janë në përbërje të Byrosë Kombëtare të Hetimit, nuk janë të një organi tjetër, ku për shkak të bashkëpunimit do ta marrë edhe atë input në punën e saj, por po flasim për atë që është e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Kjo është e saja, rregullohet prej saj dhe jo prej të tretëve në ekzekutiv.

Në lidhje me leximin e Kushtetutës për dispozitën transitore, zoti Manja, unë nuk pretendoj që t’ju imponoj leximin tim të Kushtetutës, eksperiencën në punë ndoshta e kemi të njëjtë, por siç nuk vlen opinionimi im dhe i asnjë prej 140 deputetëve, përfshirë dhe kush është këtu në komision, për t’i treguar interpretimin e ligjit një organi kushtetues, i cili ngre shqetësime, sepse është ai organ që do ta zbatoi ligjin, ne nuk kemi të drejtë të japim opinione personale dhe as t’i veshim me tagër institucional, sepse nuk e kemi, këtë e bën Kuvendi dhe Kuvendi këtë e

zgjidh me ligj. Meqë ju bini dakord që mund të zgjidhet me ligj do të thotë: a-Ka një problem dhe b-Ndoshta gjejmë konsensus.

Kështu që nuk ka nevojë as për deklarata, as për gjë tjetër. E rëndësishme është të zgjidhim problemin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, zoti Manja pikërisht këtë tha që Kushtetuta është e qartë dhe neni 179 i Kushtetutës e ka përcaktuar qartë, në mënyrë të veçantë dispozitën tranzitore për SPAK-un, por, fatkeqësisht, në këtë vend asnjëherë nuk lexojnë deri në fund ligjin , kështu që nuk lexojnë as Kushtetutën, dhe prandaj kërkojnë interpretim. Është neni 179, pika 8 është gjëja më e qartë që mund të ketë ajo Kushtetutë në dispozitë transitorë lidhur me SPAK-un dhe prokurorinë aktuale. Është shumë e qartë, është dispozitë transitorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai që do të lërë një kriminel jashtë, do të hyjë në burg vetë. Të garantoj për këtë gjë dhe e kuptuan shumë mirë, por fle diku tjetër lepurit. Unë do t'ju këshilloja që të mos mbështesni alibi që i shkojnë për ndesh frymës së kësaj reforme. Janë alibi, por, megjithatë, është çështja juaj, ju mund t'i mbështesni ato, vazhdoni t'i mbështesni siç i keni mbështetur . Prandaj jemi të detyruar të bëjmë reformë.

Kemi gjë tjetër për të shtuar?

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, kur të fillojnë të bëjnë reformë edhe për ty, është çështje tjetër pastaj, por marrim dhe bëjmë atë që është për t'u bërë, që prokuroria të vazhdojë punën dhe mos ta lëmë në boshllëk siç e keni lënë ju, ndoshta në mënyrë të qëllimshme.

Fatmir Xhafaj – Po ju ku kishit?

Oerd Bylykbashi – Elvis Roshit po i skadojnë afatet e hetimit, ka skaduar afatet, ka kërkuar pushimin gjyqimit pikërisht për shkak të kësaj.

Fatmir Xhafaj – E ke gabim, nuk ka lidhje fare me këtë.

Oerd Bylykbashi – Po të jap një shembull, ke dosje të tjera, që me u zor mbyllen kapakët.

Fatmir Xhafaj – Juve ju ka ngelur ora, por, në rregull. Po të jenë kaq injorantë atje, nuk kemi çfarë të bëjmë, por mos keni merak se ka gjykata. Skadimi i afatit nuk ka lidhje fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Je jurist me diplomë, që ta kuptosh, nuk ka lidhje skadimi i afatit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kodi i Procedurës edhe ai është me dispozitë transitore për këta, por nuk ke çfarë t'i thuash.

Në rregull.

Keni ndonjë gjë tjetër për procedurë?

Meqenëse u bë një propozim edhe nga zoti Vasili, edhe nga zoti Bylykbashi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është e përshtatshme për ju që të rimblidhemi në orën 13:00? Në rregull.

Atëherë, deri në orën 13:00 mund t'i vazhdojmë të shqyrtojmë të gjithë amendamentet që janë, një kohë e përshtatshme për të punuar dhe reflektuar. Në orën 13:00 do të rimblidhemi. Do t'i lutesha stafit tuaj dhe stafit të komisionit që amendamentet që ju keni sjellë t'i inkorporojnë tek teksti, për t'i pasur përpara si version alternativ. Këtu e mbyllim dhe rifillojmë në orën 13:00!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë